

# 1. Dimensionin Europian i Sigurimit të Cilësisë

**Raporti i Konferencës “Duke punuar për Dimensionin Europian të Cilësisë”, i mbajtur në kontekstin e Inicativës së Përbashkët të Cilësisë, Amsterdam 12-13.3.2002.**

**Marijk van der Wende dhe Don Westerheijden**

## Hyrje

1.

Teksti i mëposhtëm pasqyron çështjet kryesore që u ngritën në konferencën “Duke punuar për Dimensionin Europian të Cilësisë”, e mbajtur në Amsterdam nga data 12 deri në datën 13 mars, 2002, dhe e organizuar nga CHEPS me iniciativën e Ministrave të Arsimit të Hollandës dhe Flanders. Në konferencë morën pjesë mbi 100 pjesëmarrës nga shumica e vendeve të përfshira në procesin e Bolonjës, që përfaqësonin ministritë e arsimit, agjencitë e vlerësimit të cilësisë dhe agjencitë e akreditimit, institucione të tjera, institucione të arsimit të lartë dhe studentë.

## Treguesit e Diplomave dhe Programeve Master në Nivele të Ndryshme

2.

Ka një konsensus të pranuar gjerësisht sipas të cilit **“Treguesit e Dublinit”**, që përkufizojnë rezultatet kryesore të Programeve të Diplomave dhe Master-ave në përgjithësi (fletët për elementë përshkrimi të veçanta për Diplomat dhe Master-at) janë të dobishme. Ata plotësojnë rezultatet e projektit të informimit, i cili po zhvillohet në nivelet e zonave (disiplinave) të njohurive.

3.

Sidoqoftë, nga diskutimet doli se:

- **“Treguesit e Dublinit”** kanë nevojë që të “harmonizohen”, dhe
- rezultatet e projektit të informimit nuk duhet të merren si detyruese. Në këtë aspekt, duhet pasur parasysh se rezultatet nuk përcaktojnë kurrikulat.

4.

Përfitimet e projektit të informimit përfshijnë faktin që ka një konsensus më të gjerë sesa pritej nga institucionet Europiane të shkollave të larta ose hartuesve të programeve të tyre, duke filluar nga rezultatet dhe jo nga inputet dhe elementet e kurrikulave. Në të njëjtën kohë, ka më pak diversitet se pritej për sa i përket kohëzgjatjes/krediteve të programeve.

5.

Plotësimi nënkupton një ndërthurje të elementeve gjenerikë (nga **“Treguesit e Dublinit”**) me elementët specifikë (nga rezultatet e projektit të informimit).

6.

Këndvështrimi i ndërtimit të cilësisë mbi një kombinim të tillë të **“Treguesve të Dublinit”** dhe rezultateve të projektit Tuning i referohet mësimdhënies “tradicionale” të shkollave të larta dhe arsimit ndërkombëtar, shkollimit në distancë, etj.

7.

Në Konferencë u bë një diskutim mbi vlerën relative të programit kundrejt këndvështrimeve institucionale të sigurimit të cilësisë. Sipas mendimit të përgjithshëm, të dy këto elementë janë të rëndësishëm. »Treguesit e Dublinit« ashtu si dhe rezultatet e projektit të informimit fillimisht drejtohen në nivel programesh. Shumë, duke përfshirë përfaqësinë e studentëve, dhanë si prioritetin për politikën publike vlerësimin e nivelit të cilësisë së programit, pasi kjo mënyrë jep një siguri më direkte të cilësisë (siguron mbrojtjen e konsumatorit). Sigurimi institucional i cilësisë u pa kryesisht si përgjithësi e institucioneve autonome, të menaxhuara mirë, të shkollave të larta, megjithëse disa pjesëmarrës theksuan opinionin se me shkollat e larta »masive« ose »universale«, në një rrjet të tillë shoqëror, institucionet e tilla koherente të shkollave të larta do të bëhen dhe më të rralla.

### **Pyetje: Cfarë duhet trajtuar në hapat pasardhës?**

8.

Duke theksuar mendimin e përgjithshëm të të gjithë pjesëmarrësve në konferencë, mund të propozohen hapat e mëposhtëm, për të cilat duhet të diskutohen çështjet e mëposhtme.

### **Çështja e aplikimit**

9.

Cila është balanca e duhur midis elementëve gjenerikë dhe specifikë për strukturat e akreditimit dhe kriteret?

10.

Projektet ndërkufitare të vlerësimit të cilësisë do të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e të mësuarit për të zhvilluar një kuptim të njëjtë në nivelin Europian.

### **Çështjet e pronësisë dhe të pjesëmarrjes**

11.

Kush është i përfshirë në vendosjen e kriterëve për akreditim/vlerësim të cilësisë?

12..

Kush është i përfshirë në rifreskimin e kriterëve për akreditim/ vlerësim të cilësisë?

13.

Kush është i përfshirë në aplikimin e kriterëve në kreditimin aktual/vlerësimin aktual të cilësisë?

14.

Cilat janë implikimet e përgjigjeve të pyetjeve të mëparshme për pranimin e pasojave të (mos) kreditimit?

### **Efektet mbi institucionet e shkollave të larta**

15.

Ata duhet të zhvillojnë "kapacitetin e tyre të kreditimit", pra mënyrën se si të gjejnë informacionin e nevojshëm për vlerësime të ndryshme të cilësisë ose agjenci akreditimi.

16.

Si të mirëmbajmë rrjedhën e përmirësimit të cilësisë?

17.

Cili është/duhet të jetë kontributi i tyre në iniciativat aktuale të cilësisë? Në një anë, përfshirja e institucioneve të shkollave të larta është e nevojshme për të zhvilluar kurrikula që i përgjigjen strukturave si pjesë e autonomisë së tyre institucionale, pasi strukturat e para në këndvështrimin e rezultateve nuk përcaktojnë kurrikula që lidhen me përmbajtjen dhe formën udhëzuese.

18.

Një pyetje tjetër që mund të lidhet me përfshirjen merr parasysh inputin e shkollave të larta për përcaktimin e strukturave ose të kriterëve të vendosura ose të përdorura nga agjencitë e përcaktimit të cilësisë ose agjencitë e akreditimit.

### **Arsimi ndërkombëtar**

19.

Cështja specifike e sigurimit të cilësisë së arsimit ndërkombëtar, vecanërisht në formën e strukturave ndërvepruese (të njohura gjerësisht si rregullime “të pranuar”, por që aktualisht janë më të gjëra) u prezantua në diskutimet e Iniciativës së Përbashkët për Cilësi (JQI) në këtë konferencë.

20.

Në këtë pikë, çështja kryesore është ajo e balancimit midis përgjegjësisë për cilësi nga “dërguesi” dhe nga “marrësi”. Pjesëmarrësit pranuan gjerësisht se Kodi i Praktikës (UNESCO/Këshilli i Europës) me parimin e tij, sipas së cilit »dërguesi« dhe »marrësi« marrin përgjegjësi, në të vërtetë është një praktikë e mirë.

## **2. Drejt përcaktimit të treguesve të veçantë për Diplomat dhe Master-at**

**Një raport i hartuar nga një grup pune joformal nga Iniciativa e Përbashkët e Cilësisë (anëtarët e të cilit dhanë kontributet e tyre në diskutimet dhe hartimin e elementëve përkrahës të BaMa) përfshin elementët e dhëna në Aneksin A.**

### **I. Vështrim i përgjithshëm**

1.

Deklarata/procesi i Bolonjës propozon një hyrje, brenda një hapësire të shkollave të larta, të një sistemi kualifikimesh në nivelin universitar, i cili të bazohet në dy cikle. Cikli i parë (nën-universitar) e ka pikën kulminante në dhënien e Diplomës. Cikli i dytë i studimeve është planifikuar dhe mbështetet në atotribute të marra në ciklin e parë, që të çojnë në kualifikimet pasuniversitare, ku përfshihen Master-at dhe doktoraturat. Procesi i Bolonjës kërkon gjithashtu që të inkurajojë një nomenklaturë titujsh që të jetë e krahasueshme midis vendeve, që të jetë lehtësisht e lexueshme, për të rritur kuptimin e kualifikimeve HE dhe duke inkurajuar ata që studiojnë në hapësirën Europiane të arsimit të lartë.

2.

Një aspekt i punës së Iniciativës së Përbashkët të Cilësisë (JQI) ishte marrja parasysh e zhvillimeve të elementëve përkrahës/treguesve të Diplomave dhe Master-ave (tregues BaMa) të cilët mund të jenë të njëjtë në të gjithë Europën dhe që mund të jenë të disponueshme për shumë arsye, në varësi të konteksteve dhe të kërkesave kombëtare, rajonale dhe institucionale. Një grup me anëtarë nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të QA (Shihni Aneksin A) diskutoi kërkesat e ndryshme për tregues të tillë si dhe karakteristikat që

duhet të kishin ato. Ata kanë zhvilluar tashmë përshkrues/tregues të cilët mund të testohen dhe të ndahen.

3.

Mjaft projekte kombëtare dhe rajonale kanë punuar, ose janë duke punuar për të identifikuar karakteristikat e lidhura me kualifikime të vecanta HE, dhe për të zhvilluar elementë dhe struktura që qartësojnë marrëdhëniet midis kualifikimeve. Puna e grupit të JQI-së përfshiu mendime të hollësishme mbi projekte të tilla dhe për më tepër, nxorri rezultatet e diskutimeve në Helsinki mbi karakteristikat e Diplomave. Diskutimet në Helsinki e karakterizuan Diplomën në varësi të shtrirjes së studimit (vitet ose ECTS); puna e grupit të JQI-së u përqëndrua në identifikimin e kërkesave akademike ose kërkesave të tjera, të cilat, ashtu si rezultati i studimit, karakterizojnë dhe bëjnë dallimin midis Diplomës së thjeshtë dhe Masterit.

4.

Është bërë një sondazh me pjesëmarrësit e projektit të JQI-së për të përgatitur diskutimet mbi format e mundshme, përmbajtjen dhe aplikimin e treguesve të BaMa. Përgjigjet evidentuan shumë nevoja dhe përdorime të mundshme për përshkrues të tillë, si dhe rëndësinë e të pasurit të një kuptimi të veçantë të termave të përdorura brenda përshkruesve dhe për të përshkruar kontekstin/kontekstet në të cilat ato mund të aplikohen.

5.

Të gjithë pjesëmarrësit ranë dakord se secili element përshkrimor duhet të tregojë një përmbledhje të rezultateve të të tërë programit të studimit. Ata duhet të marrin parasysh të tërë studimin, si dhe mundësitë dhe atributet e studentëve të cilat i kanë mundësuar atyre marrjen e kualifikimeve. Treguesi nuk duhet të kufizohet vetëm thjesht në përshkrimin e rezultateve të njësisë së vlerësimit në nivelin e kualifikimit. Në këtë mënyrë, grupi ka filluar të zhvillojë një *përshkrues kualifikimi*, jo një nivel të ndarë përshkrimi. Gjithsesi, është vënë re se brenda konteksteve kombëtare, rajonale dhe institucionale, mund të ketë gjithashtu një kërkesë për zhvillimin lokal të nivelit të elementëve përshkrimorë.

6.

Grupi diskutoi rreth meritave të të kërkuarit elementë të veçantë për Diplomat dhe për Master-at, kundrejt kërkimit të një procesi për të demonstruar “përputhshmëri” midis elementeve të zhvilluar për qëllime kombëtare, rajonale ose institucionale, dhe të cilat reflektojnë detajet e konteksteve lokale. Në përputhje me esencën e procesit të Bolonjës, grupi doli në konkluzionin se ai do të kërkonte një përshkrues/tregues të vetëm gjenerik për të gjithë Master-at. Grupi njeh faktin se zhvillimet e këtyre elementëve nuk duhet të pengojnë asnjë kërkesë kombëtare, rajonale dhe lokale për elementë shtesë.

7.

Ka një gamë të gjërë programesh të cilat të drejtojnë tek Diplomat, por të cilat ndryshojnë nga përmbajtja, dhënia, procesi, dhe nomenklatura; për shembull disa vende japin Diploma Profesionale dhe Diploma Akademike. Në të njëjtën mënyrë, ka shumë programe të cilat të çojnë në tipe të ndryshme të studimeve pasuniversitare. U ra dakord që vlera e përshkruesve gjenerikë do të rritej në mënyrë të ndjeshme nëse ata mund të përfshinin profile më të hollësishme ose specifitime të kësaj natyre.

8.

Një profil programi/specializim do të indentifikojë komponentët e veçantë të programit të cilët të çojnë në kualifikim; për shembull, kjo gjë mund të kërkojë plotësimin e disa kërkesave përpara se të hyet në program, detaje për komponentët, dhënien dhe vlerësimin e tyre, si dhe

çdo kërkesë të lidhur me funksionet e rregulluara. Forma dhe komponentët brenda profilit duhet të pasqyrojnë kontekstet kombëtare, rajonale ose institucionale dhe duhet të jenë të lidhura me nevojat dhe përgjegjësitë e atyre që hyjnë në programe të veçanta.

9.

Grupi nënvizoi se, duke pasur parasysh procesin e Bolonjës, elementët përshkrimorë të veçantë do të formulohen në një gjuhë dhe stil që të jetë “i lexueshëm” nga të gjithë ata që janë të interesuar, veçanërisht për studentët, sponsorët e tyre, punëdhënësit, akademikët e HE dhe menaxherët e tyre, si dhe për publikun e gjërë. Më poshtë do të gjeni propozime të lidhura me elementët përshkrimorë gjenerikë të cilët mund të jenë të dobishëm si elementë përshkrimorë ose pika referimi për aftësitë dhe cilësitë e atyre që kanë Diploma ose Master të dhëna nga një vend që i përket hapsirës Europiane të shkollave të larta.

## II. Elementët përshkrimorë të veçantë për Diplomat dhe Master-at

### 10. Diplomat u jepen studentëve të cilët:

- kanë demonstruar njohuri dhe kuptimshmëri në një fushë studimi e cila është ndërtuar mbi shkollën e tyre të mesme dhe e ka zëvendësuar atë, dhe është në një nivel që, ndërkohë që mbështetet në tekste të avancuara, përfshin dhe disa aspekte të cilat duhet të mbulohen nga njohuritë të tjera që i paraprijnë fushës së tyre të studimit;
- mund të aplikojnë njohuritë dhe kuptimshmërinë e tyre duke demonstruar aftësi profesionale në punën ose profesionin e tyre, dhe kanë kompetencë, shpesh të treguar duke dhënë dhe argumentuar fakte dhe duke zgjidhur probleme në fushën e tyre të studimit;
- kanë mundësi të mbledhin dhe të interpretojnë të dhëna përkatëse (në përgjithësi brenda fushës së studimit) për të dhënë gjykime që përfshijnë reflektime mbi çështjet sociale, shkencore dhe etike;
- mund të komunikojnë informacione, ide, probleme dhe zgjidhje tek specialistët dhe jo-specialistët;
- kanë zhvilluar aftësitë e tyre të të mësuarit të cilat janë të domosdoshme për ta për të vazhduar të ndërmarrin studime të tjera me një shkallë më të lartë autonomie.

.....

#### 1 Fjala

Fjala 'profesional' është përdorur tek elementët përshkrimorë në kuptimin e saj më të gjërë, duke u lidhur me atotribute që përkohën me marrjen përsipër të një pune ose profesioni dhe ku përfshihen dhe aplikimi i disa aspekteve të të mësuarit të përparuar. Kjo fjalë nuk është përdorur në lidhje me kërkesat specifike që lidhen me profesionet e rregulluara. Këto të fundit mund të identifikohen me profilin/specializimin.

2 Fjala 'kompetencë' përdoret tek elementët përshkrimorë në kuptimin e saj më të gjërë, duke lejuar rritjen e aftësive dhe mundësive. Ajo nuk përdoret në kuptimin e saj më të ngushtë, i identifikuar vetëm mbi bazën e vlerësimit 'po/jo'.

.....

## 11. Diplomati Master u jepen studentëve që:

- kanë demonstruar njohuri dhe kuptimshmëri që gjenden mbi nivelin normal dhe kanë njohuri të zgjeruara të cilat përgjithësisht lidhen me nivelin e Diplomës, të cilat u ofrojnë një bazë ose mundësi për origjinalitet në zhvillimin dhe/ose aplikimin e ideve, shpesh në një kontekst kërkimor. Ata duhet të jenë në gjendje që t'i aplikojnë njohuritë dhe dijet e tyre, të kenë aftësi në zgjidhjen e problemeve në mjedise të reja ose të panjohura brenda konteksteve më të gjëra që lidhen me fushën e tyre të studimit;
- kanë mundësinë të integrojnë njohuri dhe të menaxhojnë çështje komplekse, të formulojnë gjykime me informacione jo të plota ose të kufizuara, duke përfshirë dhe pasqyrimin e përgjegjësive sociale dhe etnike të cilat lidhen me aplikimin e njohurive dhe gjykimeve të tyre;
- mund të komunikojnë në mënyrë të qartë, jo konfuze dhe racionale konkluzionet dhe diturinë e tyre tek një publik specialistësh ose jo-specialistësh;
- kanë aftësi të mira të të nxënësve që u lejojnë atyre të vazhdojnë të studiojnë në një mënyrë që mund të jetë gjerësisht e vetëdrejtuar ose autonome.

## III. Testimi dhe përshkruesit e veçantë

12. Anëtarët e grupit kanë nisur diskutimet rreth mundësive për të testuar përshkruesit BaMa në studime të përbashkëta "pilotë" të cilat përfshijnë aspekte të ndryshme të QA. Studime të tilla do të kërkojnë vëzhgimin e utilitetit të këtyre elementëve, dhe veçanërisht formën e tyre, komponentët dhe nivelin e arritjeve të pritshme. Përveç kontributit ndaj transparencës për natyrën e kualifikimeve për Diploma dhe Master, është parashikuar se vëzhgimet ndërkombëtare do të kontribuojnë gjithashtu për zgjerimin e kuptimit dhe njohjes së qëllimeve dhe karakteristikave të sistemeve të ndryshme të vlerësimit.

.....

3 Disa përfaqësues nga JQI sugjeruan se programet MBA duhet të përjashtohen specifikiisht; të tjerë mendojnë se programet MBA duhet të reflektojnë atributet e përshkruesve/treguesve të veçantë të Master-ave.

4 Termi 'kërkim' është përdorur për të mbuluar një variacion të gjërë aktivitetesh, shpesh të lidhura me fushën e studimit; termi është përdorur për të përfaqësuar një studim të kujdesshëm ose një vëzhgim duke u bazuar në një kuptim sistematik dhe në një ndërgjegjshmëri kritike të njohurive.

.....

## Aneksi A

### Ata që kanë kontribuar në diskutime dhe në hartimin e elementëve përshkrimorë të veçantë BaMa përfshijnë:

Marlies Leegwater (MinOCW; Hollande)	Bryan Maguire (NQAI; Irlande)
Dirk Van Damme (Keshilli Flameng Nder-Universitar)	Jose-Gines Mora (Keshilli i Universiteteve; Spanje)
Mark Frederiks (HBO-raad; Hollande)	Ulf Ohlund (HSV; Suedi)
Josep Grifoll (Agenqua; Catalunya)	Seamus Puirseil (HETAC; Irlande)
Nick Harris QAA; Britani e Madhe)	Hermann Reuke (ZEvA; Gjermani)
Linda de Kock (Min. Flemish Community)	Sverre Rustad (NNR; Norvegji)
Wofgang Koerner (MKW Nierdersachsen; Gjermani)	Gemma Reurat (Agenqua; Catalunya)
Cees Karssen (Trailblazer Committee, Hollande)	Ko Scheele (Insp. Onderwijs; Hollande)
Dorte Kristoffersen (EVA; Denimarke)	Christian Thune (EVA; Denimarke)
Tobias Lindeberg (EVA; Denimarke)	Noel Vercruysse (Min. Flemish Community)
Ton Vroeijenstijn (VSNU; Hollande)	Inge de Wolf (Insp. Onderwijs; Hollande)

### Ndryshimet janë:

#### *Njohuri dhe kuptimshwri*

- .. nga .. nivelet e avancuara të teksteve + .. tek .. një njohuri dhe kuptimshmëri e zgjeruar/ e konsoliduar që përbën bazën ose mundësinë për origjinalitet në zhvillimin ose aplikimin e ideve ... shpesh në një kontekst kërkimor;

#### *aplikimi i njohurive dhe kuptimi*

- .. nga .. të planifikuarit dhe të menduarit e argumentave .. tek .. fitimi i aftësive për të zgjidhur probleme në mjedise të reja ose të panjohura në kontekste më të gjëra (ose shumëdisiplinore) ..;

#### *dhënia e gjykimeve*

- .. nga.. mbledhja dhe interpretimi i të dhënave përkatëse .. tek .. të pasurit e mundësisë për të integruar njohuri, për të zgjidhur kompleksitete dhe për të formuluar gjykime me të dhëna të paplota..;

#### *komunikimi*

- .. nga .. komunikimi i informacioneve, ideve, problemeve dhe zgjidhjeve .. tek .. komunikimi i konkluzioneve të tyre nëpërmjet një mënyre racionale ..;

#### *aftësitë e të mësuarit*

- .. nga .. zhvillimi i atyre aftësive që janë të nevojshme për të studiuar në një nivel të lartë autonomie .. tek .. studimi në një mënyrë që është gjërësisht e vetëdrejtuar ose autonome.

**Perkthimi u mundesua nga SEE ECN.**  
**Perkthyer nga Center for Democratic Education.**